



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA BERAT
DREJTORIA E SHËRBIMIT SOCIAL**

RELACION

**MBI PËRDORIMIN E FONDIT TË SHËRBIMIT SOCIAL, MBËSHTETJE
FINANCIARE NË RASTE FATKEQËSIE PËR TË NDJERËN ZNJ. VALBONA
HOXHALLARI**

Drejtoria e Shërbimit Social dhe Drejtoria e Financës, bazuar në kërkesën e bërë nga **znj. Sidorela Hoxhallari me** nr. 6110 prot, datë 14.11.2024, mbështetur në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr. 57/2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, V.K.M-së nr. 597 , datë 04.09.2019, e ndryshuar, datë 29.12.2021, “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike” vendimit nr. 722, datë 11.11.2019 “Për përcaktimin e masës, të kriterëve, procedurave dhe dokumentacionit për vlerësimin dhe përfitimin e aftësisë së kufizuar e të ndihmës personal, dhe të strukturave përgjegjëse e të detyrave të tyre”, VKB-së nr.3, datë 27.01.2025 “Për miratimin e kriterëve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok - ndihmën ekonomike deri në 6% dhe nga fondet e drejtorisë së Shërbimit Social”, VKB-së nr.108, datë 18.12.2024 “Per miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe PBA përfundimtare 2025-2027”, ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” neni 4 pika 4, ligjin nr.121/2016 “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, vendim nr. 518, datë 03.10.2018 “Për procedurat e referimit e të menaxhimit të rastit, hartimin dhe përmbajtjen e planit individual të mbrojtjes, financimin e shpenzimeve për zbatimin e tij, si dhe zbatimin e masave të mbrojtjes”, ligjin nr. 22/2018 “Për Strehimin Social”, ligjin nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve”.

JU RELATOI:

Të nderuar këshilltarë!

E ndjera **znj. Valbona Hoxhallari**, anëtare e komunitetit egjiptian, banore e lagjes “Donika Kastrioti”, ka ndërruar jetë më datë 14.11.2024 nga Arrest kardio-respirator në vendin e punës. Znj.Valbona prej shumë vitesh punonte në ndërmarrjen e pastrimit të qytetit, në orët e natës, pasi ishte e vetmia në familje që siguronte të ardhura ekonomike. Gjendja e saj shëndetësore prej kohësh ishte e rëndë pasi shfaqte shqetësime kardiake dhe mjekohej.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Pas kërkesës së vajzës së saj, e cila së bashku me të vëllain jetonin në një banesë me nënën, kërkon mbështetje financiare për pagesën e shpenzimeve të varrimit.

Pasi jemi njohur me kërkesën e znj.Hoxhallari është ngritur grupi i punës për identifikimin dhe vlerësimin e situatës social ekonomike aktuale të familjes. Familja Hoxhallari prej vitesh është identifikuar dhe është mbështetur si familje me vështirësi dhe problematika të ndryshme social-ekonomike nga Bashkia Berat. Si familje nga grup vulnerabël është mbështetur me shërbime mbështetëse dhe fuqizimin për integrimin social-ekonomik nga drejtoria e Shërbimit Social. Dy prej fëmijëve janë mbështetur me pagese mujore në zbatim të ligjit "Për statusin e jetimit" në bazë të VKM-së nr.233 datë 14.10.1998, janë asistuar duke ju ofruar falas ndihmë juridike parësore dhe dytësore për zgjidhjet e martesave, janë referuar në OJF për mbështetje ekonomike në vazhdim duke u mbështetur konkretisht me qera banesa, paketa ushqimore, blerje medikamentesh etj.

Pas vizitës në familje, identifikuam nevojat imediate dhe kushtet social-ekonomike. Tipologjia e banesës ku ata jetonin ishte një ambient i mbuluar me internit, ku duhet të zbrisje me shkallë për të hyrë në banesë, pothuajse i pa ndarë në dhoma, në mungesë të orendive shtëpiake dhe jo i përshtatshëm për të jetuar.

Pas ndërrimit të jetës së nënës, fëmijët nuk kanë më asnjë mundësi financiare për pagesën e shpenzimeve të varrimit.

Duke u bazuar në historikun e familjes dhe në vlerësimin socio-ekonomik, pamundësive financiare për të përballuar shpenzimet e varrimit, kërkesës së paraqitur nga vajza Sidorela Hoxhallari, drejtoria e Shërbimit Social, propozon të përballoj shpenzimet e varrimit, në shumën 120.000 (njëqind e njëzet mijë) lekë.

Bashkangjitur gjeni:

- 1.Certifikatë familjare Kadri Hoxhallari.
- 2.Certifikata e vdekjes.
- 3.Fotokopjet e kartës për z.kadri Hoxhallari
- 4.Deklaratë noteriale nga znj, Marsela Hoxhallari.
- 5.Deklaratë noteriale nga znj, Sidorela Hoxhallari.
- 6.Kërkesa e znj.Sidorela Hoxhallari.
- 7.Formulari i aplikimit në sistemin e NE.




REPUBLIKA E SHQIPËRISË

8.Faturë tatimore nga subjekti AB.ZOGA SH.P.K.

9.Korespondenca me Shërbimin Social.

DREJTOR I SHËRBIMIT SOCIAL

Piro Xheplati





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

DREJTORIA E MBROJTJES CIVILE, PRONAVE TRANSPORTIT DHE SHËRBIMEVE

RELACION

MBI MIRATIMIN E SISTEMIT TË PIKËZIMIT PËR FAMILJET E PASTREHA QË DO TË PËRFITOJNË NGA PROGRAMET SOCIALE TË STREHIMIT

Të nderuar Këshilltarë !

Bashkia Berat, mbështetur në nenin 15 dhe 16 të ligjit të ligjit nr.22/2018, "Për strehimin social" i ndryshuar, ka hartuar sistemin e pikëzimit, për çdo program strehimi që ne jemi duke zbatuar, bazuar në kriteret e përcaktuara në këtë ligj.

Ne jemi duke zbatuar programin e banesave me kosto të ulët, ku futet dhe programi i subvencionimit të interesave të kredisë, programin e bonusit të qirasë si dhe projekti i përmirësimit të banesave për komunitete të varfëra dhe të pafavorizuara .

Hartimi i sistemit të pikëzimit është i domosdoshëm për klasifikimin e kërkesave për strehim, mbështetur në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.384, datë 12.06.2019 "Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetqeverisjes vendore" si dhe të VKM-së nr.852, datë 26.12.2024 "Për procedurën e paraqitjes së kërkesës, afatet kohore, përgjegjësitë dhe rolet e përdoruesve të sistemit për përfitimin nga programet e strehimit social". Sistemi i pikëzimit mund të miratohet çdo vit dhe është i ndryshëm për çdo lloj programi të strehimit që ne jemi duke zbatuar. Nga sa më sipër, po ju paraqesim për miratim sistemin e pikëzimit për familjet e pastreha që do të përfitojnë nga programet sociale të strehimit të ndara si më poshtë :

Sistemi i pikëzimit për familjet që kanë aplikuar për banesë me kosto të ulët dhe subvencionim të interesave të kredisë.

Nr	Kriteret e përzgjedhjes	Sistemi i pikëzimit	Sistemi i pikëzimit i detajuar
1.	Kushtet e strehimit si familje: A) Nuk disponojnë banesë në pronësi B) Banojnë në banesa rrezik shembjeje C) Të pastrehë nga fatkeqesitë natyrore dhe vendimet gjyqësore. Ç) Banojnë në banesa me sipërfaqe nën normat e strehimit	30	9 7 9 5
2.	Kushtet familjare: A) Familje njëprinderore që ka në ngarkim fëmijë ku përfshihen edhe vajzat nëna. B) Të moshuar që kanë mbushur moshën e pensionit C) Familje me më shumë se katër fëmijë. Ç) Familje e re quhet familja kur mosha e anëtarit më të madh është më e vogël ose baras me 40 vjeç me moshë totale deri në 60 vjeç.	20	6 5 5 4

3.	Kushtet sociale: A) Familjet që kanë në përbërjen familjare PAK dhe invalide. B) Individët me statusin e jetimit deri në 30 vjeç. C) Emigrant i rikthyer, punëtor emigrant. Ç) Familje të policëve të rënë në detyrë. D) Viktima të dhunës në familje. E) Anëtarët e komunitetit Rom e Egjiptian	30	6
			6
			4
			5
			5
			4
4.	Kushtet ekonomike: A) Të ardhura deri në 80 %-100 % të të ardhurave mesatare. B) Të ardhura 100 %-120% të të ardhurave mesatare.	20	12
			8

Sistemi i pikëzimit për familjet që kanë aplikuar për banesë sociale, bonus qiraje dhe për projektin "Përmirësim i banesave ekzistuese, për komunitete të pavavorizuara".

Nr	Kriteret e përzgjedhjes	Sistemi i pikëzimit	Sistemi i pikëzimit i detajuar
1.	Kushtet e strehimit si familje: A) Nuk disponojnë banesë në pronësi B) Banojnë në banesa rrezik shembjeje C) Të pastrehë nga fatkeqësitë natyrore dhe vendimet gjyqësore. Ç) Banojnë në banesa me sipërfaqe nën normat e strehimit	30	9
			8
			8
			5
2.	Kushtet familjare: A) Familje njëprindërore që ka në ngarkim fëmijë ku përfshihen edhe vajzat nëna. B) Të moshuar që kanë mbushur moshën e pensionit C) Familje me më shumë se katër fëmijë. Ç) Familje e re quhet familja kur mosha e anëtarit më të madhë është me e vogël ose baras me 40 vjeç .	20	6
			5
			5
			4
3.	Kushtet sociale: A) Familjet që kanë në përbërjen familjare PAK dhe invalide. B) Individët me statusin e jetimit deri në 30 vjeç. C) Emigrant i rikthyer, punëtor emigrant. Ç) Familje të policëve të rënë në detyrë. D) Viktima të dhunës në familje. E) Anëtarët e komunitetit Rom e Egjiptian	30	6
			6
			4
			5
			5
			4
	Kushtet ekonomike:		

4.	A) Familje pa të ardhura, familje me ndihmë ekonomike, familje vetëm me pagesat e papunësisë, familje me të ardhurat nga paaftësia. B) Familje me të ardhura mujore shumë të ulëta, më të ulëta se 70% e të ardhurave mesatare . C) Familje me të ardhura të ulëta, midis 70 dhe 100 % e të ardhurave mesatare .	20	8
			7
			5

DREJTOR I MBROJTJES CIVILE, PRONAVE, TRANSPORTIT DHE SHËRBIMEVE

Sokol Toska



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT
DREJTORIA E MBROJTJES CIVILE, PRONAVE, TRANSPORTIT DHE SHËRBIMEVE

RELACION

**“ MBI MIRATIMIN E KËRKESËS SË BASHKISË BERAT, SË BASHKU ME
DOKUMENTACIONIN TEKNIKO - LIGJOR PËR AKORDIMIN E NDIHMËS
FINANCIARE PËR FAMILJEN E Z. DALIP KANAÇI BANESA E TË CILIT ËSHTË
DËMTUAR NGA ZJARRI, NGA BUXHETI I BASHKISË DHE BUXHETI I VITIT 2025
NË MINISTRINË E MBROJTJES, PROGRAMI “EMERGJENCAT CIVILE”**

Të nderuar këshilltarë,

Në datën 01.01.2025 nga zjarri i rënë u dëmtua banesa e z.Dalip Kanaçi ndodhur në Fshatin Dyshnik, Njësia Administrative Otllak, Bashkia Berat.

Pas arkivimit të kërkesës së z.Dalip Kanaçi, datë 06.01.2025 komisioni i ngritur me Urdhërin Nr. 13 datë 08.01.2025 të Kryetarit të Bashkisë “Për ngritjen e komisionit për konstatimin e dëmeve të shkaktuara nga rënia e zjarrit në datën 01.01.2025 në banesën me pronar z.Dalip Kanaçi ndodhur në Fshatin Dyshnik, Njësia Administrative Otllak, Bashkia Berat, shkoi në vendngjarje dhe në bazë të konstatimit fizik, hartoi proces verbalin e dëmeve të shkaktuara, mbështetur në VKM Nr.329 datë 16.05.2012 “Për kriteret për procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”. Proces verbali i konstatimit u dërgua në Këshillin e Qarkut me shkresën nr.176 Prot, datë 14.01.2025 për vlerësimin e dëmeve sipas ligjit. Komisioni i Ekspertëve të Këshillit të Qarkut, ka përfunduar vlerësimin e dëmeve të shkaktuara në banesën e z.Dalip Kanaçi dhe është përcjellë në Bashkinë Berat me shkresën nr.61/2 Prot, datë 21.01.2025.

Në mbështetje të preventivit të hartuar nga grupi i ekspertëve dërguar në Bashkinë Berat rezultojnë dëmet:

1. Në banesën e z.Dalip Kanaçi në vlerën	781,466 lekë.
- Punime ndërtimore	293,966 lekë
- Orendi dhe pajisje	487,500 lekë

Bazuar në dokumentacionin që disponojmë dhe mbështetur në VKM nr.329 datë 16.05.2012, shkronja “ç”, të pikës 1, të Kreut III, i propozojmë Këshillit Bashkiak të miratoj vlerën e ndihmës së menjëherëshme financiare për:

Familjen e Z.Dalip Kanaçi në vlerën 390,733 lekë.

Ndihma financiare do të përballohet nga fondet e emergjencës së Bashkisë për sigurimin e jetës dhe kushteve të përkohëshme të jetesës, si dhe për shpenzime të tjera për përballimin situatës emergjente.

DREJTOR I MBROJTJES CIVILE, PRONAVE, TRANSPORTIT DHE SHËRBIMEVE

Sokol Toska

Adresa: Blvd. “Republika 2”, Berat 5001. Shqipëri,

Website : www.bashkiaberat.gov.al, Email : info@bashkiaberat.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT

RELACION

**MBI MIRATIMIN NË PARIM TË PROJEKTIT “NDËRTIM QËNDRA RINORE
LAPARDHA DHE TË FONDEVE TË BASHKËFINANCIMIT”**

Të nderuar Këshilltarë ,

Bashkia Berat, është shpallur fituese e projektit me titullin “Ndërtim Qendra Rinore Lapardha” bashkëfinancuar nga Agjencia Kombëtare e Rinisë.

Shuma totale e projektit është 24,574,893 Lekë nga të cilat 8,984,135 Lekë mbulohen nga Agjencia Kombëtare e Rinisë ndërsa shuma 15,335,758 Lekë është bashkëfinancimi i Bashkisë Berat.

Nëpërmjet këtij projekti do të kryhet rikonstrukcion total i ish-pallatit të Kulturës Lapardha duke e kthyer në një qendër multifunksionale për të rinjtë, një kërkesë e vazhdueshme e komunitetit të zonës.

Projekti synon përmirësimin në përgjithësi të infrastrukturës publike në shërbim të përmirësimit të jetës kulturore dhe nxitjes së kohezionit social të të rinjve në njësitë administrative Otllak. Parashikohet që ndërtesa të kthehet në një qendër rekreative për të rinjtë, të cilët mund të kenë mundësi të krijojnë aftësi të reja, të zhvillojnë talentet dhe njohuritë e tyre, si dhe në një qendër e rëndësishme e zhvillimit të komunitetit në fshatrat Lapardha I dhe II dhe në fshatrat e njësive administrative Otllak.

Qendra pritet të jetë një pikë referimi e rëndësishme për të rinjtë e zonës dhe më gjerë.

Qendra Rinore në Lapardha, do të jetë si një qendër satelitore e Qendrës Rinore Berat, duke replikuar aktivitetet e kësaj qendre, por edhe aktivitete të reja, për të rinjtë e fshatit Lapardha dhe fshatrave përreth të Njesisë Otllak, të cilët nuk kanë mundësi të ndjekin aktivitetet dhe shërbimet që ofrohen në Qendrën Rinore Berat. Në këtë mënyrë, shtrihet diapazoni i shërbimeve për të rinjtë, edhe në zonat më larg qytetit, duke u ofruar po të njëjtat mundësi si në qytet dhe zonën rurale, pa i privuar fëmijët e fshatrave për të patur një jetë sociale dhe kulturore sipas kërkesave të tyre.

Si rrjedhojë kërkohet miratimi në parim i këtij projekti nga Këshilli Bashkiak Berat si dhe miratimi i alokimit të bashkëfinancimit në vlerën 15,335,758 Lekë.

Kjo shumë do të rialokohet nga programi buxhetor AB102, projekti i investimeve me Kod P452AAV "Investime të reja në infrastrukturën rrugore përfshirë shpenzimet për supervizime, kolaudime, shpronësime", për të cilin është miratuar në buxhetin e vitit 2025 shuma 54,930,193 Lekë. Nga ky fond propozojmë të përdoret shuma 15,335,758 Lekë për bashkëfinancimin e projektit "Ndërtim Qendra Rinore Lapardha".

Faleminderit,

DREJTORE E PLANIFIKIMIT URBAN, LEJEVE DHE INVESTIMEVE

Arjana Marini



DREJTORI I INTEGRIMIT EUROPIAN DHE PROJEKTEVE

Marius Qytyku



DREJTORE E FINANCË BUXHETIT

Rovena Shehu





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT

Berat, më ____ . ____ . 2025

RELACION

MIRATIM NË PARIM I PROJEKTI “SHKOLLA E MESME E BASHKUAR “KOÇO BRISKU” - LAPARDHA, NJ.A. OTLLAK, BASHKIA BERAT” DHE TË FONDEVE TË BASHKËFINANCIMIT

Të nderuar Këshilltarë!

Bashkia Berat ka përfunduar hartimin e projektit **Rikonstruksion “Shkolla e Mesme e Bashkuar “Koço Brisku” - Lapardha, Nj.A. Otllak, Bashkia Berat**”. Ky projekt synon të rehabilitojë në gjendje optimale Shkollën e Mesme të Bashkuar në fshatin Lapardha. Midis të tjerash është përzgjedhur kjo shkollë për gjendjen e saj jo të mirë, për numrin e nxënësve që ka si dhe të komunitetit që i shërbën.

Aktualisht shkolla ka një problematikë të gjerë të cilat adresohen në mënyrë shteruese në këtë projekt. Përmes këtij projekti disa nga ndërhyrjet kryesore do të konsistojnë në hidroizolim të themeleve dhe tarracës, zëvendësimin e dyshemesë në katin përdhe, zëvendësimin e tubave të shkarkimit, riparimin e dëmeve në strukturë të shkaktuar nga cilësia e materialeve jo të mira, mungesa e ndërhyrjeve të mëparshme konstruktuese dhe mirëmbajtëse, etj. Punimet e reja që do të kryhen do të garantojnë një rezistencë mekanike të përmirësuar të objektit, stabilitet dhe rritjes të aftësisë mbajtëse të tij. Gjithashtu do të përmirësohet ndjeshëm kapaciteti sizmik i strukturës.

Këtë projekt, Bashkia Berat parashikon ta aplikojë pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit në thirrjen e shpallur prej këtij institucioni për financimin e projekteve të reja me cikël financimi 2025-2026. Nevojitet miratimi juaj i këtij projekti aplikimi i tij pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve si dhe miratimi i bashkëfinancimit të tij në vlerën 20 % të vlerës totale të projektit.

Shuma e bashkefinancimit do të rialokohet nga fondet për investime të parashikuara për vitin 2025.

Faleminderit,

DREJTORE E PLANIFIKIMIT URBAN, LEJEVE DHE INVESTIMEVE

Arjana Marini

DREJTORI I INTEGRIMIT EUROPIAN DHE PROJEKTEVE

Marius Qytyku

DREJTORE E FINANCË BUXHETIT

Rovena Shehu



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT

Berat, më _____.2024

RELACION

MBI MIRATIMIN E "TRANSFERIMIT SI KAPITAL I MJETIT KAMION, DHE 50 TABELA METALIKE NE FAVOR TË SHOQËRISË BERAT GREEN CITY-BCG SH.A."

Të nderuar Këshilltarë!

Bashkia Berat është përfituese e projektit Ndarja në Burim e Mbetjeve Urbane në Bashkinë Berat. Ky projekt financohet nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe është në partneritet me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit. Në kuadër të këtij projekti, Bashkia është përfituese e një metodologjie për ndarjen e mjeteve në burim, asistencës teknike për zhvillimin e kapaciteteve për menaxhimin e modelit të ri si dhe të infrastrukturës së nevojshme për mbledhjen e diferencuar të mbetjeve në burim

Projekti ka dhuruar për Bashkinë Berat një mjet tip kamion i cili do të shërbejë për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve si dhe 50 tabela metalike. Të dhënat e mjetit dhe pajisjeve janë si më poshtë.

a. Kamion Iveco Daily 70C16H30 me kazan për transport mbeturinash. Numri serial i mjetit NK124054. Numri i shasisë së mjetit: ZCFCE70B305667875. Vlera e mjetit: 9,200,400 Lekë

b. 35 tabela metalike me tub Vlera e tabelave: 259.000 Lekë

c. 15 tabela metalike pa tub Vlera e tabelave 82.500 Lekë

Ky mjet dhe tabelat nevojiten të transferohen në pronësi të Shoqërisë Berat City Green - BCG SH.A e cila është edhe ndërmarrja përkatëse që merret me administrimin dhe mbledhjen e diferencuar të mbetjeve. Nevojitet miratimi juaj për transferimin si kapital i mjeteve të cituara më sipër në favor të Shoqërisë Berat City Green - BCG SH.A

Faleminderit,

KRYETARI BASHKISË
Ervin DEMO





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT

Berat, më _____. _____. 2025

RELACION

MBI MIRATIMIN E MANUALIT OPERACIONAL “NDARJA E MBETJEVE SHTËPIAKE NË
BASHKINË BERAT” SI DHE TË SHTOJCAVE TË TIJ.

Të nderuar Këshilltarë!

Bashkia Berat është përfituese e projektit “Ndarja në Burim e Mbetjeve Bashkiake në Bashkinë Berat” financuar nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim Ndërkombëtar për Zhvillim (SIDA) si dhe zbatohet në partneritet me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, me asistencë teknike nga Brooks Hannas & Partners dhe Instituti i Kërkimeve Urbane.

Projekti mbulon zonën urbane të Beratit dhe synon të rrisë normat e riciklimit dhe të harmonizojë menaxhimin e mbetjeve të Beratit me standardet e BE-së, duke mbështetur objektivat mjedisore të Shqipërisë.

Nëpërmjet këtij projekti janë hedhur hapa të rëndësishëm në drejtim të grumbullimit të diferencuar të mbetjeve dhe riciklimit të tyre. Në qytet është vendosur infrastruktura e nevojshme, e cila përfshin kosha të diferencuar për grumbullimin e mbetjeve sipas llojit të tyre, janë blerë automjetet e nevojshme për kryerjen e shërbimit si dhe ëshë krijuar qendra e selektimit dhe magazinimit të mbetjeve. Kjo detyrë zbatohet nga Shoqëria Aksionere Berat City Green.

Me qëllim standardizimin e funksionimit e aktivitetit për ndarjen e mbetjeve në burim së bashku me partnerët kemi krijuar këtë manual operacional shoqëruar nga anekeset e tij. Ky manual përshkruan situatën ekzistuese si dhe udhëzon institucionin përkatës mbi mënyrën e kryerjes së detyrave që ato të jenë sa më të plota, funksionale dhe eficiente. Manuali udhëzon në lidhje me procedurat e vendosjes së kontenejrëve, grumbullimin dhe transportin e diferencuar të mbetjeve, mënyra e funksionimit të qëndrës së selektimit, procedurat për shitjen e materialit të ricikluar, mënyrat e komunikimit dhe ndërgjegjësimit, etj.

Ju ftoj të njiheni më këtë Manual Operacional si dhe shtojcat e tij dhe ta votojmë për të lehtësuar dhe standardizuar punën e Berat City Green.

KRYETARI I BASHKINË
Ervin DEMO





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT

Berat, më _____._____.2025

RELACION

PËR MIRATIMIN NE PARIM TË PROJEKTIT DHE MIRATIM NË PARIM TË PROCEDURËS SË
SHPRONËSIMIT *“Ndërhyrje në infrastrukturën turistike të aventurës Zip line ne fshatin
Roshnik”*

Të nderuar Këshilltarë!

Bashkia Berat është përzgjedhur përfituese nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit për projektin *“Ndërhyrje në infrastrukturën turistike të aventurës Zip line në fshatin Roshnik”*, në kuadër të thirrjes të hapur nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit.

Projekti parashikon ndërtimin e një zip line në fshatin Roshnik. Pikat në të cilat do të ndërtohet zip line janë të aksesueshme, me rrugë të përshtatshme. Pika e fillimit është pranë qendrës së fshatit. Ajo është e aksesueshme dhe e shtruar me asfalt. Afër saj ka vend parkimi dhe ndriçim. Pika e mbarimit është pranë liqenit të Roshnikut. Rruga që lidh liqenin me rrugën kryesore është rehabilituar në vitet e fundit dhe është lehtësisht e kalueshme për të gjitha llojet e automjeteve. Relievi është i butë në vendin e propozuar, përfshirë edhe në zonën përreth, duke pasur një pjerrësi të lehtë e cila nuk rrihet nga erëra të forta. E gjithë gjatësia e zip-line është 917 m.

Ndërtimi i një zip line është i përshtatshëm për fshatin Roshnik, për vetë natyrën e tij gjithnjë e më shumë turistike si dhe për tiparet e tij gjeografike. Ndërtimi i këtij projekti do të ndihmojë edhe më shumë zhvillimin e Roshnikut si një destinacion eko-turizmi si dhe do të pasurojë përvojën e turistëve që vijnë në Berat dhe do të rrisë kohën e tyre të qëndrimit në qytet.

Si rrjedhojë e procedurave, është e nevojshme që nga Këshilli Bashkiak i Bashkisë të miratohet në parim projekti *“Ndërhyrje në infrastrukturën turistike të aventurës Zip line në fshatin Roshnik”* si dhe të miratohet fillimi i procedurave të nevojshme të shpronësimit të pronave që preken nga ky ndërtim.

Faleminderit,

KRYETARI I BASHKISË
Ervin DEMO



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT

KOMISIONI I SHPRONËSIMEVE

Berat, më 25.02.2025

Relacion

MBI MIRATIMIN E SHPRONËSIMIT PËR INTERES PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTËSHME PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT: "REHABILITIM I NYJES SE TRAFIKUT SPITALI RAJONAL ,BASHKIA BERAT "

Të nderuar Këshilltarë,

Në mbështetje të ligjit Nr. 8561, datë 25.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", të ndryshuar, VKM-së nr. 127 datë 23.03.2000 për "Përmbajtjen dhe procedurat e paraqitjes së kërkesës dhe të njoftimit për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", Bashkia Berat ka filluar procedurat e shpronësimit për interes publik për pasuritë pronë private, për gjithsej 3(tre) bashkepronarë, të pronës të llojit "truall" të ndodhura në Zonën Kadastrale 8502, për të cilat kerkohet miratimi juaj lidhur me vijimin e procedurave të shpronësimit për realizimin e projektit "REHABILITIM I NYJES SE TRAFIKUT SPITALI RAJONAL ,BASHKIA BERAT "

Projekti më sipër dhe miratimi në parim të procedurave të shpronësimit, është miratuar nga Këshilli Bashkiak me VKB nr.66 datë 26.09.2024.

Komisioni për procedurat e shpronësimit për interes publik, bazuar në dokumentacionin përkatës të projektit "REHABILITIM I NYJES SE TRAFIKUT SPITALI RAJONAL ,BASHKIA BERAT " dhe këqyrjen në vend, thekson se prona private që preken nga realizimi i këtij projekti shtrihen në zonën kadastrale 8502.

Pasuria që preken nga investimi, pasuri tokë "truall" me pronarë privatë, janë bashkëngjitur tabelës ku çmimet e shpronësimit përlllogariten dhe janë përcjellë nga Agjensia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Berat.

Në bazë të nenit 10 pika c) e ligjit nr. 8561 datë 25.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", të ndryshuar, kërkohet si pjesë e dokumentacionit nga Agjencia Shqiptare e Shpronësimit, edhe miratimi nga Këshilli Bashkiak për shpronësimin e pronarëve që preken nga projekti "REHABILITIM I NYJES SE TRAFIKUT SPITALI RAJONAL ,BASHKIA BERAT ". Tre bashkepronarët e pronës private të llojit "truall", do të shpronësohen për pjesët e pronës që do të preken nga projekti, bazuar në çmimet e miratuara sipas legjislacionit në fuqi, marrë me shkresë zyrtare nga Agjensia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Berat.

Vlera totale e shpronësimit është: 954,092 lekë për pronën që shpronësohen për 3 bashkepronarë, prone të llojit "truall".

Fondi për përballimin e kostos financiare të shpronësimit do të përballohen nga Buxheti i Bashkisë.

Faleminderit

N/Kryetare e Bashkisë
Etleva DHIMA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT

Berat, më __. __. 2025

RELACION

PËR MIRATIMIN e ***“Memorandumit të Bashkëpunimit ndërmjet Bashkisë Berat dhe Projektit Bashki të Forta”***

Të nderuar Këshilltarë!

Bashkia Berat ka qenë përfituese e projektit Bashki të Forta. Bashki të Forta është një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC dhe Qeverisë së Suedisë, i zbatuar nga Helvetas Swiss Intercooperation (Helvetas).

Afati i këtij projekti është zgjatur nga donatorët edhe për dy vitet ne vijim, 2025, 2026. Si rrjedhojë nevojitet që zgjatja e afatit të miratohet edhe nga Bashkia Berat në mënyrë që të vijojë të jetë përfituese e këtij projekti.

Në kuadër të këtij memorandumi, Bashkia Berat përfiton bashkëpunim dhe mbështetje në fushat e mëposhtme:

- Përmirësim i ofrimit të shërbimeve (menaxhimi i mbetjeve dhe arsimi parashkollor) drejt standardeve më të përshtatshme dhe më të përballueshme.
- Rritja e kapaciteteve të këshillave bashkiakë për ushtrimin e mandatit bazuar në ligje dhe aktet rregullatore vendore dhe për të mbikëqyryr në mënyrën e duhur performancën e administratës bashkiake.
- Krijimi dhe funksionimi i një sistemi të ri të menaxhimit të performancës bashkiake dhe i një mekanizmi granti të bazuar në performancë.
- Fusha të tilla bashkëpunimi, si gjinia, përfshirja sociale dhe ndryshimet klimatike, digjitalizimi, lufta kundër korrupsionit, bashkëpunim me mediat, shoqërinë civile dhe institucionet e pavarura.

Ju ftoj të njiheni me memorandumin e bashkëpunimit dhe ta miratojmë në shërbim të Bashkisë dhe qytetit Berat.

Faleminderit,

Drejtoria e Integrimit Evropian dhe Projekteve
Marius Qytyku



17

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT

RELACION

**PËR NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR. 108 DATË
18.12.2024 “ PËR MIRATIMIN E BUXHETIT TË BASHKISË BERAT PËR VITIN
2025 DHE PBA 2025-2027 ”,
(shtesa e buxhetit me fondet e papërdorura të trashëguara nga viti 2024)**

Të nderuar këshilltarë!

Mbështetur në ligjin nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 40, pika 1, neni 41, pika c, 54, gërma “dh”, neni 64 gërma “c”, ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 6, gërma “d”, neni 28, pika 5, ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, Udhëzimin plotësues nr. 2 datë 24.01.2025 të Ministrit të Financave “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2025”; Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 108 datë 18.12.2024 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Berat të vitit 2025 dhe PBA 2025-2027”, në këtë material ju paraqesim shtesën e buxhetit të vitit 2025 me fondet e papërdorura të trashëguara nga viti 2024 në vitin 2025, dhe propozimin për alokimin e tyre në shpenzime korrente dhe kapitale, në programe buxhetore dhe njësi shpenzuese.

Bashkia Berat miratoi buxhetin e vitit 2025 me VKB nr. 108 datë 18.12.2024 konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Berat me shkresën nr.889/1 datë 24.12.2024 në shumën 1,545,268,802 lekë.

Drejtoria e Financës e Bashkisë Berat pas mbylljes së vitit buxhetor 2024, kreu rakordimet përfundimtare me degën e Thesarit për gjithë të ardhurat/ arkëtimet për llogari të bashkisë Berat për periudhën 01.01.2024 - 31.12.2024, si edhe për shpenzimet/pagesat deri më 31.12.2024.

Bashkia Berat në fund të vitit 2024 rezulton me këtë situatë financiare :

I. TOTALI I FINANCIMEVE (TË HYRAT) në Lekë : 1,477,955,605.56 lekë

në lekë

1. Fonde nga Transferta e Pakushtëzuar e Përgjithshme v. 2024.....	493,355,047.68
2. Fonde nga Transferta e Pakushtëzuar Sektoriale e v.2024.....	326,008,731.72
3. Fonde nga Të ardhurat e vitit (Realizimi i planit të të ardhurave v. 2024)....	463,666,727.26
4. Fonde Të trashëguara nga viti 2023 në vitin 2024	194,925,098.90
• të ardhura lokale	128,895,056.51
• transfertë e pakushtëzuar e përgjithshme.....	26,285,178.98
• transfertë e pakushtëzuar sektoriale	39,744,863.41

TOTALI I FINANCIMEVE (TË HYRAT)..... 1,477,955,605.56



18

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT

II. TOTALI I SHPENZIMEVE (TË DALAT) në Lekë : 1,309,523,281.00 lekë

Buxheti i vitit 2024 është realizuar/financuar me fondet sipas burimeve më poshtë:

në lekë

1. Transferta e Pakushtëzuar e Përgjithshme..... 456,030,943.00
2. Transferta e Pakushtëzuar Sektoriale 343,260,992.00
3. Të ardhurat e veta/ lokale 510,231,346.00

III. FONDE TË PAPËRDORURA QË TRASHËGOHEN NGA VITI 2024 NË VITIN 2025
në Lekë (kapitull 01+05): 168,432,324.56 lekë

në lekë

1. Transferta e Pakushtëzuar e Përgjithshme..... 63,609,283.66
2. Transferta e Pakushtëzuar Sektoriale 22,492,603.13
3. Të ardhurat e veta/ lokale 82,330,437.77

Sipas akt-trashëgimisë të mbajtur me degën e thesarit Berat shuma e të ardhurës që trashëgohet në vitin 2025 është **168,432,324.56** lekë, e cila rezulton si më poshtë :

në lekë

Kapitulli	Emërtimi	Trashëguar nga viti 2023	Çelur në vitin 2024	Totali i të ardhurave 2023+2024	Përdorimi në vitin 2024	Mbetje trashëgimi për vitin 2025
01	Transferta e Përgjithshme e Pakushtëzuar	26,285,178.98	493,355,047.68	519,640,226.66	456,030,943.00	63,609,283.66
01	Transferta e Përgjithshme Sektoriale	39,744,863.41	326,008,731.72	365,753,595.13	343,260,992.00	22,492,603.13
01	Shuma kap. 1	66,030,042.39	819,363,779.40	885,393,821.79	799,291,935.00	86,101,886.79
05	Të Ardhurat e Veta (pjesa e institucionit)	128,895,056.51	463,666,727.26	592,561,783.77	510,231,346.00	82,330,437.77
	Shuma (kap. 1+5)	194,925,098.90	1,283,030,506.66	1,477,955,605.56	1,309,523,281.00	168,432,324.56
06	Sponsorizime	1,839,113.42	2,459,654.00	4,298,767.42	2,882,765.00	1,416,002.42
	TOTALI (kap. 1+5+6)	196,764,212.32	1,285,490,160.66	1,482,254,372.98	1,312,406,046.00	169,848,326.98

Gjithashtu bashkia Berat trashëgon nga viti 2024 të ardhura jashtë limitit (sponsorizime, kapitull 06) në shumën 1,416,002.42 Lekë, të cilat janë me destinacion për financimin e shpenzimeve të përcaktuara në kontratën e sponsorizimit. Këto fonde detajohen dhe përdoren vetëm në destinacionin përkatës .



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT

Lista e projekteve të sponsorizuara :

Sponsorizime (llog. 7207011)	programi	llog.	Trasheg. nga viti 2023	shtesa 2024	2024	Perdorur ne vitin 2024	Mbeten per t'u trasheg. ne v. 2025
Alpha Bank, sponsorizim per rikonstruksionin e Shatervanit	AB102	231	205,000		205,000		205,000
Erasmus +	AA102	602	503		503		503
Sposnsorizim FLAG Projekti "Siguria publike ne nivel vendor"	AB102	231	562,000		562,000		562,000
Save the Children, "Kend sportiv dhe rekreativ ne shkollen Velabisht, Berat"	AC102	231	32,870		32,870		32,870
"Askush te mos mbetet si ju"	AC102	600	269,336		269,336	269,336	0
"Askush te mos mbetet si ju"	AC102	601	57,814		57,814	57,814	0
"Askush te mos mbetet si ju"	AC102	602	111,469		111,469	85,869	25,600
"Askush te mos mbetet si ju"	AC102	231	600,121		600,121	442,080	158,041
"Te ndryshem por te barabarte"	AC102	600		1,075,111	1,075,111	945,285	129,826
"Te ndryshem por te barabarte"	AC102	601		179,543	179,543	157,861	21,682
"Te ndryshem por te barabarte"	AC102	602		230,000	230,000	99,520	130,480
"Trans adriatik pipeline"	AD102	602		975,000	975,000	825,000	150,000
Shuma Sponsorizime			1,839,113.42	2,459,654.00	4,298,767.42	2,882,765.00	1,416,002.42

Detajimi i fondeve të papërdorura të trashëguara nga viti 2024 në vitin 2025

1. Transferta e Pakushtëzuar Sektoriale e trashëguar nga viti 2024 është në shumën 22,492,603.13 lekë

Sipas Ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", neni 28, pika 5, fondet e papërdorura të transfertës së Pakushtëzuar Sektoriale në fund të vitit buxhetor, trashëgohen në vitin buxhetor pasardhës në të njëjtin funksion për të cilin janë dhënë në vitin e mbyllur buxhetor.

Në këtë situatë, propozojmë që fondet e papërdorura të trashëguara nga viti 2024, shuma 22,492,603.13 lekë të alokohen në funksionet e mbrojtjes civile, arsimit, kujdesit social, dhe bujqësisë. Gjithashtu detajojmë në po të njëjtat zëra objektsh edhe fondet e transferuara për bashkëfinancime dhe pagesë tvsh-je të projekteve me financim të huaj, të cilat rezultojnë të papërdorura në vitin 2024.

Detajimi i transfertës sektoriale së trashëguar 22,492,603.13 lekë :



70

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT

Kod Institucioni	Kap. Fin.	Programi	Produkti	Llog.	Pershkrimi	Shuma lek
2102001		Bashkia Berat (Aparati)				9,101,122.00
		AB102	Shërbimet Publike, Infrastruktura & Emergjencat Civile			2,910,464.00
2102001	01.1	AB102	V091AAC	606	Transferta për Buxh. Fam. & Individë Familje të dëmshpërblyera për dëme nga fatkeqësitë natyrore	2,533,052.00
2102001	01.1	AB102	V644AAB	231	Bashkefinancim per projektin "Projekti i ndricimit publik eficient ", fond MFE	377,412.00
		AC102	Arsimi & Kujdesi Social			807,415.00
2102001	01.1	AC102	V912AAK	231	Projekti Sherbime Multifunksionale ne sektorin e arsimit, fond MFE	555,415.00
2102001	01.1	AC102	P413AAC	231	Bashkefinancim per projektin "Fuqizimi ekonomiko-shoqeror i Ballkanit Perendimor.Mbeshtetje per bizneset dhe punekerkesit", fond MFE	252,000.00
		AE102	Siguria dhe Mbrojtja e Territorit			4,763,623.00
2102001	01.1	AE102	V328AAC	602	Raste të menaxhuara të zjarrit dhe shpëtimit	2,482,089.00
2102001	01.1	AE102	V328AAA	231	Pagese TVSH-je te projekteve me financim te huaj "FIRE PREP Permiresimi i Mbrojtjes nga zjarri ne pyje ne Shqiperi dhe Greqi", i financuar nga BE nepermjet Programit Nderkufitar Greqi-Shqiperi , fond MFE	1,813,058.00
2102001	01.1	AE102	V328AAA	231	Pagese Bashkefinancimi per projektin me financim te huaj "FIRE PREP Permiresimi i Mbrojtjes nga zjarri ne pyje ne Shqiperi dhe Greqi", i financuar nga BE nepermjet Programit Nderkufitar Greqi-Shqiperi, fond MFE	468,476.00
		AF102	Turizmi, Kultura dhe Sportet			619,620.00
2102001	01.1	AF102	V813AAD	231	Fond MFE per pagesën e TVSH për projektin me financim te huaj " Culture Lands", projekt i financuar nga programi nderkufitar IPA CBC, Greqi-Shqiperi	117,894.00
2102001	01.1	AF102	V813AAD	231	Fond MFE per pagesën e TVSH për projektin me financim te huaj " E-Natura", projekt i financuar nga programi nderkufitar IPA CBC, Greqi-Shqiperi	501,726.00
2102005		Drejtoria Arsimore Bashkia Berat				8,559,597.00
		AC102	Arsimi & Kujdesi Social			8,559,597.00
2102005	01.1	AC102	V912AAK	231	Hidroizolimi i shkolles 9-vjecare "Zihni Toska"	3,000,000.00
2102005	01.1	AC102	V923AAI	231	Hidroizolimi i tarraces se konviktit "Kristo Isak" dhe i rrjetit te hidrosanitareve	2,929,514.00
2102005	01.1	AC102	V923AAB	231	Blerje paisje kompjuterike per stafin.	538,362.00
2102005	01.1	AC102	V912AAE	231	Projekti "Krijimi i platformes digjitale qe permban te dhena analitike per kopshtet" dhe trajnim stafi. (Miratuar me VKB nr.36 date 29.05.2024 Plan-permiresimi i sherbimit per Arsimin Parashkollor)	2,091,721.00
2102020		Qendra "Lira"				185,852.13
		AC102	Arsimi & Kujdesi Social			185,852.13
2102020	01.1	AC102	V043AAB	602	Shpenzime operative dhe mirembajtje	185,852.13
2102022		Drejtoria e Bujqësisë, Administrimit të Pyjeve , Ujërave dhe Shërbimit Veterinar				4,646,032.00



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT

21

		AD102	Bujqësia, Administrimi i Pyjeve, Ujërave, Shërbimi Veterinar & Siguria Ushqimore			4,646,032.00
2102022	01.1	AD102	V424AAA	231	Veshje me beton kanal ujites Veterik	1,200,000.00
2102022	01.1	AD102	V424AAB	231	Blerje Orendi zyra	76,032.00
2102022	01.1	AD102	V424AAB	231	Blerje paisje kompjuterike	300,000.00
2102022	01.1	AD102	V424AAB	231	Blerje Fotokopjuese	150,000.00
2102022	01.1	AD102	V424	231	Hidroizolim i zyrave te Drejtorise se Bujqesise	1,000,000.00
2102022	01.1	AD102	V424AAB	602	Shpenzime për Karburant	800,000.00
2102022	01.1	AD102	V424AAB	602	Shpenzime per mirembajtje dhe riparime te ndryshme	120,000.00
2102022	01.1	AD102	V426AAD	602	Shpenzime per mirembajtje Lera malore fshati Veleshje	750,000.00
2102022	01.1	AD102	V426AAB	231	Blerje mjete pune moto sharra	250,000.00
					Total	22,492,603.13

2. Transferta e Pakushtëzuar e Përgjithshme e trashëguar dhe Të Ardhurat e Veta/Lokale të trashëguara nga viti 2024 në shumën 145,939,721.43 lekë

Propozojmë të bëjmë shpërndarjen e fondeve si më poshtë :

- ✓ 62,557,271.43 lekë shtesë në buxhetin e njësisë shpenzuese Bashkia Berat (qendra) për pagesën e detyrimeve të vitit 2024, si edhe për kontratat e investimeve që vazhdojnë nga viti 2024 në 2025.
Nga këto,
 - për shpenzime që rrjedhin nga vendimet gjyqësore shkojnë 25,000,000 lekë
 - për shpenzime operative, shërbimi i pastrimit shkojnë 11,626,960.00 lekë,
 - për investime në process që vijnë nga viti 2024 shkojnë 25,930,311 lekë .
- ✓ 82,448,450 lekë shtesë në buxhetin e njësisë shpenzuese Agjencia e Shërbimeve Publike , fonde për shërbimet e mirëmbajtjes së rrjetit rrugor rural dhe urban, mirëmbajtjen e rrjetit të ndriçimit publik, shërbimin e gjelbërimit dhe të dekorit, shpenzime personeli. Gjithashtu edhe për shpenzime për vendosjen e kamerave në ambientet publike : parkimi në lagjet "Kala" dhe "Gorice", parku "Dua të luaj".
- ✓ 934,000 lekë shtesë në buxhetin e njësisë shpenzuese Drejtoria e Bujqësisë, Administrimit të Pyjeve , Ujërave dhe Shërbimit Veterinar , për shpenzime personeli.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT

Shpërndarja e fondeve të transfertës së pakushtëzuar dhe të ardhurave vendore të trashëguara, shuma 145,939,721.43 lekë, si më poshtë :

Kod Institucioni	Kap. Fin.	Programi	Produkti	Llog.	Pershkrimi	Shuma lek
2102001	Bashkia Berat (Aparati)					62,557,271.43
2102001		AA102	Menaxhimi & Shërbimet Mbështetëse			27,500,000.00
2102001	01	AA102	V111AAG	602	Shpenzime per detyrimet nga vendimet gjyqesore	25,000,000.00
2102001	01	AA102	P111AAM	231	Mjet per sherbimet mbeshtetese te Bashkise	2,500,000.00
2102001		AB102	Shërbimet Publike, Infrastruktura & Emergjencat Civile			31,832,936.00
2102001	01	AB102	P452AAU	230	Detyre projektimi per ndertimin e qendres multifunksionale dhe parkim nentokesor Bashkia Berat vazhdim nga v.2024	4,800,000.00
2102001	05	AB102	P452AAV	231	Vendosje tendash ne Tregun e Gjelbert Berat-Green Market , vazhdim nga v. 2024	6,905,976.00
2102001	05	AB102	P452AAV	231	Rehabilitim i nyjes se trafikut tek Spitali Rajonal Berat, vazhdim nga v. 2024	8,500,000.00
2102001	05	AB102	V510AAB	602	Sherbimi i pastrimit , detyrime kontraktuale per efektet e ndryshimit te pages minimale	11,626,960.00
2102001		AC102	Arsimi & Kujdesi Social			3,224,335.43
2102001	05	AC102		231	Mbikqyrje punimesh per objektin "Ndertim i shkolles 9-vjecare "22 Tetori" parkim nentokesor", vazhdim nga v. 2024	2,470,414.43
2102001	05	AC102	P923AAG	231	Ndërtim shkolla "Babë Dudë Karbunara", bashkëfinancim me MAS (mbetje situacioni perfundimtar I v. 2024)	753,921.00
2102004	Agjencia e Shërbimeve Publike					82,448,450.00
		AB102	Shërbimet Publike, Infrastruktura & Emergjencat Civile			82,448,450.00
2102004	05	AB102	V452AAA	600	Shërbimi dhe pagesa e pagave dhe sigurimeve për sektorin e Rugëve Rurale	11,620,000.00
2102004	01	AB102	V626AAA	600	Shërbimi dhe pagesa e pagave dhe sigurimeve shoqërore për sektorët e mirëmbajtjes, gjelbërimit, menaxhimit të varrezave,	10,450,000.00
2102004	01	AB102	V626AAA	600	Shërbimi dhe pagesa e pagave dhe sigurimeve shoqërore për sektorët e mirëmbajtjes, gjelbërimit, menaxhimit të varrezave,	20,859,283.66
2102004	05	AB102	V626AAA	600	Shërbimi dhe pagesa e pagave dhe sigurimeve shoqërore për sektorët e mirëmbajtjes, gjelbërimit, menaxhimit të varrezave,	219,166.34
2102004	05	AB102	V452AAB	602	Mirëmbajtje rutinë dhe periodike e infrastrukturës rrugore rurale., sigurimi i mjeteve dhe bazës materiale për pastrim kanali, mbushjes së gropave me cakull, beton ose asfalt; etj.	8,000,000.00
2102004	05	AB102	V626AAD	602	Mbjellje, sherbim, dhe mirëmbajtja pemëve dekorative dhe shkurre me gjelberim te perhershëm,	1,800,000.00
2102004	05	AB102	V626AAI	602	Shpenzime per dekorin e qytetit	500,000.00



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT

73

2102004	05	AB102	V626AAI	602	Shpenzime per dekorin e qytetit	500,000.00
2102004	05	AB102	V644AAB	602	Rrjeti aktual i ndriçimit i mirëmbajtur dhe funksional në zonat qytet të NJVQV	14,000,000.00
2102004	05	AB102	V644AAB	602	Rrjeti aktual i ndriçimit i mirëmbajtur dhe funksional në zonat qytet të NJVQV	10,000,000.00
2102004	05	AB102	V644AAC	602	Rrjeti aktual i ndriçimit i mirëmbajtur dhe funksional në zonat rurale të NJVQV	4,000,000.00
2102004	05	AB102		231	Blerje pajisje kamera sigurie per ne ambientet publike (parkimi ne lagjet "Kala" dhe "Gorice", parku "Dua te luaj"	500,000.00
2102022	Drejtoria e Bujqësisë, Administrimit të Pyjeve , Ujërave dhe Shërbimit Veterinar					934,000.00
		AD102	Bujqësia, Administrimi i Pyjeve, Ujërave, Shërbimi Veterinar & Siguria Ushqimore			934,000.00
2102022	05	AD102	V422AAD	600	Shpenzime per paga	800,000.00
2102022	05	AD102	V422AAD	601	Shpenzime per sigurime shoqerore	134,000.00
Total						145,939,721.43
					<i>nga te cilat :</i>	
	1				<i>total shpenzime te financuara nga transferta e pakushtezuar</i>	63,609,283.66
	5				<i>total shpenzime te financuara nga te ardhurat vendore</i>	82,330,437.77

Shpërndarja e fondeve të transfertës së pakushtëzuar dhe të ardhurave vendore të trashëguara, shuma 1,416,002.42 lekë, si më poshtë :

Kod Institucioni	Kap. Fin.	Programi	Llog.	Pershkrimi	Shuma lek
2102001	06	AC102	600	"Te ndryshem por te barabarte"	287,600.00
2102001	06	AC102	601	"Te ndryshem por te barabarte"	48,029.00
2102001	06	AC102	602	"Te ndryshem por te barabarte"	130,000.00
2102001	06	AD102	602	"Trans adriatik pipeline"	150,000.00
2102001	06	AB102	231	Alpha Bank, sponsorizim per rikonstruksionin e Shatervanit	205,000.00
2102001	06	AA102	602	Erasmus +	503.42
2102001	06	AB102	231	Sposnsorizim FLAG Projekti "Siguria publike ne nivel vendor"	562,000.00
2102001	06	AC102	231	Save the Children, "Kend sportiv dhe rekreativ ne shkollen Velabisht, Berat"	32,870.00
				Total	1,416,002.42



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT

Pas shtesës në buxhet të fondeve të trashëguara, buxheti 2024 i bashkisë Berat bëhet 1,715,117,129 lekë .

Totali i Shpenzimeve të Bashkisë sipas kategorive ekonomike

në lekë

Emertimi i Artikullit	Kodi artikullit	2025	2025	2025
		Plan buxheti me ndryshime	Shtesa e te ardhures se trasheguar	Plan buxheti pas shteses
Paga dhe Sigurime		793,130,054	44,418,079	837,548,133
Paga, shperblime & Tjera Personeli	600	672,684,160	44,236,050	716,920,210
Sigurimet shoq. & Shendetesore	601	120,445,894	182,029	120,627,923
Korente te tjera		537,808,000	82,578,457	620,386,457
Mallra dhe Shërbime të Tjera	602	365,224,000	80,045,405	445,269,405
Subvencione	603	29,000,000		29,000,000
Transferta Korrente të Brendshme	604	124,994,000		124,994,000
Transferta për Buxh. Fam. & Individë	606	6,590,000	2,533,052	9,123,052
Rezervat	606	12,000,000		12,000,000
Shpenzimet Kapitale		214,330,748	42,851,791	257,182,539
Kapitale të Patrupëzuara	230	37,098,555	4,800,000	41,898,555
Kapitale të Trupëzuara	231	175,630,193	38,051,791	213,681,984
Te dala per hua-dhenie dhe nen-huadhenie te brendeshme	255	1,602,000		1,602,000
Totali		1,545,268,802	169,848,327	1,715,117,129

Buxheti 2025 sipas njësive shpenzuese pas shtesës me fondet e trashëguara nga v. 2024 :

Nr	Njesia Shpenzuese	2025	%	2025	2025	%
		Plan Buxheti Fillestar		Shtesa me fondet e trasheguara	Plan Buxheti pas shtesave	
1	Bashkia Berat (qendra)	711,956,459	46.1%	73,074,395.9	785,030,855	45.8%
2	Agjencia e Shërbimeve Publike	265,087,982	17.2%	82,448,450.0	347,536,432	20.3%
3	Drejtoria Arsimore Bashkia Berat	404,866,414	26.2%	8,559,597.0	413,426,011	24.1%
4	Qendra Kulturore " M. Tutulani "	71,252,000	4.6%	-	71,252,000	4.2%
5	Drejtoria e Bujqesise	57,213,097	3.7%	5,580,032.0	62,793,129	3.7%
6	Qendra "Lira"	34,892,850	2.3%	185,852.1	35,078,702	2.0%
	total buxhet	1,545,268,802	100%	169,848,327.0	1,715,117,129	100.0%

Ju faleminderit ,



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT

GRUPI I MANAXHIMIT STRATEGJIK

Ervin DEMO
Kryetar i Bashkisë (NA)

Bledar ÇILI
N/Kryetar i Bashkisë
Drejtore i NJ.SH. Drejtoria e Bujqësisë

Joana MELËNGU
N/Kryetar i Bashkisë
Drejtore i NJ.SH. Agjencia e Shërbimeve Publike

Rovena SHEHU
Drejtore i Financës dhe Buxhetit (Sekretar i GMS)

Marius QYTYKU
Drejtore i Integritimit Europian dhe Planifikimit Strategjik

Petro SINJARI
Drejtore i Drejtorisë Juridike

Sokol TOSKA
Drejtore i Mbrojtjes Civile, Pronave Transportit dhe, Shërbimeve

Artan MERKO
Drejtore i MZSH

Klodiana HOXHA
Drejtore i NJ.SH. Drejtoria Arsimit

Alma KULE
Drejtore i NJ.SH. Qendra "LIRA"

Arisa TOSKA
Sekretar i Përgjithshëm (Koordinator)

Etleva DHIMA
N/Kryetar i Bashkisë